

Pasqyra e lëndës

Hyrje f. 2

Pjesa e parë

Ligjërimi studentor: shqyrtime teorike

- § 1. *Një përkufizim i vështirë* f. 4
§ 2. *Mekanizmat e përftimit të njësive* f. 37
§ 3. *Efemeriteti i njësive* f. 56
§ 4. *Ka edhe tabu* f. 65

Pjesa e dytë

Anketa dhe rezultatet

- § 1. *Një sprovë për anketimin* f. 72
§ 2. *Modeli i pyetësorit* f. 73
§ 3. *Rezultatet e pyetësorit* f. 79
§ 4. *Lista e fjalëve sipas dendurisë së përdorimit* f. 84
§ 5. *Fjalësi* f. 89

Përfundime f. 94

Bibliografia f. 95

Sintesi f. 99

Hyrje

Ky punim në thelb përfaqëson një përpjekje për të hetuar sjelljen gjuhësore të studentëve të Universitetit të Tiranës. Një zgjedhje e tillë, më fort se nga ndonjë parapëlqim i imi, ka qenë e diktuar nga rrethanat, të cilat deshën që unë të studioja e më pas të jepja mësim pranë këtij universiteti. Kështu që edhe lënda e mbledhur vjen më së shumti këtij grupi studentësh. Prandaj punimi, edhe pse mban një titull ‘gjithëpërfshirës’, nuk mëton të ngërthejë të tjera realitete, brenda ose jashtë Shqipërisë politike.

Ai e ka zanafillën te bindja ime se shfaqje të kësaj natyre na japin mundësi ta kundrojmë gjuhën në kushte laboratorike. Me këtë nuk dua të them se studentët krijojnë një ‘gjuhë të re’ e aq më pak nga hiçi, por se ata gjatë atij procesi (ri)shenjimi të qëllimshëm, shumë më intensiv se ai që vërehet në variantet e tjera të repertorit, na ndihmojnë për të kuptuar më mirë pse e si lindin ‘fjalët’, si aklimatizohen e, ç’është më e rëndësishmja, pse vdesin.

Në të vërtetë, pas viteve ’90 të shekullit të shkuar sjellja gjuhësore e studentëve të Universitetit të Tiranës është bërë më se një herë objekt studimi edhe në këndvështrimin sociolinguistik, kujtoj me këtë rast punimet e prof. Gjovalin Shkurtajt, të dr. Marjana Ymerit e të ndonjë tjetri. Por ato përfaqësojnë vetëm hapat e parë e, për më tepër, të drojtur, në një terren thuajse të virgjër.

Përfitoj nga rasti të falënderoj udhëheqësin shkencor të këtij punimi, prof. Gjovalin Shkurtajt, për nxitjen dhe ndihmën e pakursyer që më ka dhënë gjatë gjithë këtyre viteve. Gjithashtu një falënderim i sinqertë i shkon prof. Françesko Altimarit dhe prof. Mateo Mandalasë për durimin dhe dashamirësinë e treguar ndaj meje.

Pjesa e parë

Shqyrtime teorike

1. Një përkufizim i vështirë

«Zanafilla e gjuhës nuk duhet kërkuar në anën prozaike, por në atë poetike të jetës; burimi i fjalës nuk është serioziteti melankonik, por loja e gëzuar dhe të qeshurat e të rinjve... Në gjuhën primitive dëgjoj thirrjet e hareshme kur vashat e djelmohat bënin garë me njëritjetrin për të tërhequr vëmendjen e seksit të kundërt, kur secili me këngët më të gëzueshme dhe me vallet më të bukura nxiste një palë sy të hidhnin vështrime admirimi në drejtimin që u interesonte. Gjuha ka lindur ato ditë kur njerëzimi dashurohej.»

*Oto Jespersen [1921]**

Ligjërimi studentor ka nisur të bëhet vërtet pjesë e interesave të gjuhëtarëve shqiptarë pas viteve '90 të shekullit të shkuar. Ndonjë vërejtje lidhur me dallimet gjuhësore mes brezave të folësve, e bërë aty-këtu, kryesisht prej dialektologëve¹, s'mjafton për të dëshmuar një interesim të njëmendët. Nuk bëjnë përjashtim nga ky rregull as vërejtjet e holla të prof. Qemal Haxhihasanit, i cili, në një studim mbi ato që i quan *të folme shoqnore*, i lë fare pak vend sjelljes gjuhësore të nxënësve të Normales së Elbasanit në vitet 1930 – 1935². Megjithatë, duhet

* Cituar sipas George Yule, *Introduzione alla linguistica*, Mulino, Bologna, 2001, f. 11. (Citimet në gjuhë të huaj janë përkthyer në shqip prej meje, me përjashtim të atyre nga rusishtja, për të cilat falënderoj prof. Thanas Fekën. A.D).

¹ Shih Gjovalin Shkurtaj, *Sociolinguistika*, SHBLU, Tiranë, 1996, f. 166.

² Shih Qemal Haxhihasani, *Të folmet shoqnore. Dogançja, e folmja shoqnore e zejtarëve shëtitës të rrethit të Përmetit dhe të Leskovikut. Elemente nga fjalori i dogançes, fragmente bisedash dhe tekste në këtë të folme*, në Studime filologjike, 1,2,3, Tiranë, 1964.

thënë se ky autor ka meritën të jetë i pari që e kapërceu cakun e konsideratave të përgjithshme mbi shqipen e grupeve të veçanta shoqërore. Ai njoftoi praninë e disa sociolekteve, analizoi në rrafshin leksikor një lëndë të pasur gjuhësore prej variantit që pati bërë objekt studimi (dogançes), si dhe u rrek të japë një mënyrë klasifikimi për këto variante. E vërteta është se që prej 1964-ës deri pas 1990-ës askush tjetër, madje as vetë Haxhihasani, nuk e rrahu më ballas çështjen e variacionit diastratik brenda shqipes e, afërmendsh, as atë të ligjërimit të studentëve. Për këtë mungesë interesimi unë gjej vetëm dy shpjegime alternative: një ligjërimit i tillë nuk ka ekzistuar më parë; në qoftë se ka ekzistuar, nuk e ka tërhequr vëmendjen e gjuhëtarëve, prandaj nuk është përshkruar prej tyre.

Lindja dhe përhapja e ligjërimeve rinore në Evropë është kundruar thujse gjithmonë si e lidhur ngushtë me lëvizje të llojit *Wandervögel*³, *montenapi*⁴ ose *paninari*⁵. Këto qenë të afta të prodhohnin nga të ashtuquajturat subkultura që i kundërviheshin asaj zyrtares nën hisen e qiellit që u takonte, të rrezatonin modë në mënyrën e të sjellit, të të veshurit dhe të të folurit e, ç'është më e rëndësishmja, të fito-

³ Lëvizje gjimnazistësh berlinezë nga radhët e borgjezisë së mesme, e themeluar që më 1896, që pati si parim bazë ripërtëritjen e rinisë nëpërmjet përballjes me natyrën, larg limontisë dhe veseve të qytetit. Më 1904 ata nxorën edhe revistën e tyre me të njëjtin emër që ka kuptimin 'zogjtë shtegtarë'. Anne-Marie Thiesse, *Krijimi i identiteteve kombëtare, Evropa e shekujve XVIII – XX*, Përktheu nga frëngjishtja Etleva Shiroka, Dukagjini, Pejë, 2004, f. 312-313.

⁴ Pinjoj familjesh të pasura, të cilët u quajtën kështu ngaqë mbledheshin zakonisht në rrugën Montenapoleone, njëra prej rrugëve më elegante të Milanos së viteve '50 të shekullit të shkuar. Me ta lidhen format e para të zhargonit rinor në Itali.

⁵ Në mes të viteve '80 një lëvizje të rinjsh, që e mori emrin nga "paninotekat", të parat fast-food-e në Itali. Paninarët kishin një atdhe të tyrin, Milanon, kishin revistën e tyre, "il Paninaro", e cila diktonte rregullat e të bërit pjesë në këtë lëvizje, ose, që ta themi më shkoqur, përcaktonte elementet që lipsej t'i dallonin ata nga pjesa tjetër e shoqërisë. Për të qenë një paninar duhej medoemos të ushqehesh me hamburger, të mbathje këpucë Timberland, të vishje një xhup Monclair, të vije një rrip El Charro, të flisje si Enzo Braschi (Enco Braski) në emisionin "Drive In" të Italia 1, si dhe të endeshe rrugëve të qytetit majë motoçikletës Honda.

nin ndjekës. Pikërisht për këto arsye ato dhe simotrat e tyre mbahen edhe sot e gjithë ditën si një kusht i nevojshëm për ekzistencën e ligjë-rimeve rinore. Një tjetër kusht, që mundëson e mundësohet prej të parit, është dhe ai i hapësirave që lipset të kenë të rinjtë për të shpallur e njëmendësuar identitetin e tyre si grup shoqëror⁶. Nuk ngjan e rastit që manifestime të tilla gjuhësore hasen rëndom nëpër qendra të mëdha urbane, aty ku pushteti homogjenizues i familjes dhe trysnia dialektore nuk janë aq të forta sa tjetërkund. Kjo ka bërë që shpesh ligjërimet rino-re të çmohen si elemente të një substandardi që po i detyron të tërhiqen variantet diatopike⁷. Kushti i fundit për nga radha, por jo për nga rën-dësia, lidhet me një masmedia që u bën jehonë risive të shfaqura në sjelljen gjuhësore të të rinjve, sepse ajo nga njëra anë u jep këtyre “saje-save” njëfarë prestigji e, bashkë me të, edhe të drejtën e qytetarisë, ndërsa, nga ana tjetër, e lehtëson mjaft përhapjen e tyre.

Në optikën e të tilla kushteve, të cilat, edhe sipas mendimit të ndonjë studiuesi⁸, kishte pak gjasë të kënaqeshin në Shqipërinë komu-niste të paranëntëdhjetës, nuk është fort e vështirë të arrihet në përfun-dimin se për ligjërim studentor në shqipe mund të flitet vetëm pas kësaj date⁹. Duket se këtij përfundimi i vjen në ndihmë edhe fakti që doku-mentimi i këtyre ‘varianteve’ te ne është thujse inekzistent krahasuar me atë që vërehet në gjuhë të tjera¹⁰. Por, nëse dokumentimi i cilësdo shkallë do të dëshmonte kurdoherë për ekzistencën e këtyre ligjërim-eve, e bashkë me të edhe për interesimin (jo vetëm shkencor) lidhur me

⁶ Shih Edgar Radtke, *La dimensione internazionale del linguaggio giovanile*, në *Il linguaggio giovanile degli anni novanta*, botuar nën kujdesin e Emanuele Banfi-t dhe Alberto Sobrero-s, Laterza & figli, Bari, 1992, f. 7.

⁷ Shih Edgar Radtke, po aty, f. 9.

⁸ Shih Marjana Ymeri, *Zhargoni dhe dëshmitë e tij në gjuhën shqipe*, në Gjuha jonë, 1-2, Tiranë, 2002, f. 22-33.

⁹ Shih Marjana Ymeri, po aty, f. 33.

¹⁰ Vlera e shkallës së dokumentimit si një tregues mirëfilli sasior relativizohet mjaft edhe po të krahasohet, fjala vjen, situata e një vendi si Italia me atë të Gjermanisë e kështu me radhë.

to, mungesa e tij nuk provon detyrimisht që të tilla entitete s'kanë ekzistuar. Gjithashtu, nuk duhet harruar që asnjëri prej kushteve të lartpërmendura nuk përbën një *conditio sine qua non* lidhur me ekzistencën e ligjërimeve rinore të gjuhës, ngaqë është e vështirë që ato të njësohen me shkaqet që i përftojnë dukuritë në fjalë.

Nga ana tjetër, ndonëse falë ndalimeve të imponuara prej diktaturës së proletariatit të ne nuk u institucionalizuan dot lëvizje rinore si ato që zura ngoje më lart, studentët shqiptarë e, në mënyrë të veçantë, ata të Universitetit të Tiranës, nuk kanë qenë asnjëherë krejtësisht të izoluar prej proceseve ku përfshiheshin të ngjashmit e tyre. Në qoftë se deri në agun e viteve '70 kontaktet me botën e jashtme qenë mbajtur kryesisht përmes librave, qofshin këta edhe *të verdhë*¹¹, kinemasë e radios, pas kësaj periudhe të rinjve do t'u vinte në ndihmë edhe një aleat tjetër i madh, televizori. Vetë lufta kundër të ashtuquajturave "shfaqje të huaja", e cila u ashpërsua edhe më pas pranverës jetëshkur-tër liberale të fillimviteve '70, me fletërrufetë, dëbimet dhe internimet, në një këndvështrim tjetër tregon se Partia nuk e pati të lehtë me "qafë-leshët"¹². Një shfaqje të qartë, sipas meje, të subkulturave rinore (për shumëkënd edhe të kundërkulturave) në Shqipërinë e paranëntëdhjetës e gjejmë tek ato që njihen me emrin *Këngët e liqenit*¹³.

¹¹ Kështu quheshin edhe dhjetë vjet më vonë prej të rinjve librat e nxjerrë nga qarkullimi ose të ndaluar. Në Shqipëri, gjatë dyzet e gjashtë vjetëve komunist, edhe pse nuk ka pasur ndonjë organ censure të njohur me ligj, kishte organizma që bënin punën e censurës. Shtëpitë botuese (asokohe vetëm shtetërore), Lidhja e Shkrimtarëve dhe e Artistëve të Shqipërisë, madje edhe komitetet e Partisë, kishin tagër të vendosnin nëse një libër ishte i përshtatshëm ose jo. Në rastin e fundit libri nuk mund të botohej osdhe as të qarkullonte lirisht.

¹² Kështu quheshin prej 'moralistëve' të rinjtë që guxonin të mbanin flokë të gjatë. Më pas, me anën e një zgjerimi kuptimor, fjala u përdor për të shënuar të gjithë të rinjtë që në një mënyrë a në një tjetër përipiqeshin të ndiqnin modën e huaj, duke e ruajtur gjithsesi ngjyrimin përkeqësues.

¹³ Këto këngë u kompozuan dhe u kënduan nga të rinjtë e Tiranës për të paktën tri dekada jashtë skenës së festivaleve ku nuk ngjiteshin dot, sepse i kundërviheshin muzikës që kishte bekimin e Partisë në formë e në përmbajtje. Ato i kushtoheshin dashurisë, gazeve e

Bir i tyre, jo vetëm nga pikëpamja kohore, por edhe në frymë, ishte grupi muzikor *Matura '72*. Po t'i zëmë besë njërit prej protagonisteve të *Këngëve të liqenit*, si fjala vjen, Adhurim Demirit, ato janë krijuar e kënduar pa ndërprerje deri më 1987. Pra, nuk është e vërtetë se ky grup (*Matura '72*) lindi nga hiçi, dhe aq më pak se mbeti një dukuri e veçuar¹⁴.

Janë pikërisht këto arsye që më shtyjnë të mendoj se do të ishte më e udhës ta largonim së paku nja dhjetë vjet në kohë “datëlindjen” e ‘variantëve’ rinore të shqipes. E për këtë kemi dy lloj dëshmish, të tërthorta e të drejtpërdrejta. Prej të parave ia vlen të përmend atë që na sjell prof. Androkli Kostallari, i cili shkruan: «...norma letrare ndeshet me kundërnormën në dy drejtime: me *të vjetrën* (korsivi është i imi, A.D), pra me trysninë e dialekteve, si dhe me *të renë*, me atë që krijohet rishtaz, por që nuk pajtohet as me veçoritë e sistemit e të strukturës së gjuhës letrare, as me prirjet e zhvillimit të saj...»¹⁵. Afërmendsh që *e reja* e krijuar rishtaz nuk ka të bëjë vetëm me çka mund të përftohej në ligjërimet rinore të shqipes, sepse të rinjtë nuk janë të vetmit prodhues risish. Por, sa kohë bëhet fjalë për krijimin e një kundërnorme, ose thënë ndryshe të një substandardi edhe në të folur, ne nuk kemi të drejtë t'i përjashtojmë *a priori* ata nga procese të tilla. Dëshminë e dytë të këtij lloji na e sjell Edgar Radtke, i cili, duke rrahur çështjen e ligjëtimeve rinore në vendet e Evropës Lindore, pohon se «...edhe në vendet e tjera socialiste [pra jo vetëm në Gjermaninë Lindore] orientimet e veçanta politike (edhe ato të politikës gjuhësore) nuk kishin pranuar kurrë prirje që mund t'i vinin në pikëpyetje parimet zyrtare, fortësisht

bregave që sjell ajo, nën ritmet e xhazit e të rock-ut, prandaj qenë të dënuara të luheshin në kodrat e Liqenit Artificial të Tiranës, prej nga morën edhe emrin.

¹⁴ Marjana Ymeri, në artikullin e cituar, f. 31, shfaq një mendim të kundërt.

¹⁵ Androkli Kostallari, *Mbi disa drejtime të përsosjes së sistemit e të strukturës së gjuhës letrare*, në Studime filologjike, 2, Tiranë, 1982, f. 7.

homogjenizuese. Megjithatë, këto orientime nuk ia dolën të pengonin përhapjen edhe në këto vende të ligjërimeve rinore...»¹⁶, ndërsa më tej po ky autor shton se «...duke nisur që nga vitet '80 të rinjtë e vendeve socialiste filluan të adoptonin qëndrime të ngjashme me lëvizjet e subkulturat rinore të markës perëndimore»¹⁷.

Si dëshmi të drejtpërdrejtë në favor të hipotezës sime mund të sjell vërejtjet e prof. Qemal Haxhihasanit në lidhje me të folmen e nxënësve të Normales. E, po ashtu, një të dhënë që na vjen nga Ismail Kadare. Në romanin *Dimri i vetmisë së madhe* ky autor rrëfen edhe për djemtë e “Rrugës së Dibrës”, një pjesë e së cilës, e pikërisht ajo që të nxjerr te Teatri i Operës dhe Baletit, që pagëzuar nga të rinjtë e Tiranës që në mesin e viteve '60 me emrin *Broduej*. Ka ende njerëz që e mbajnë mend shprehjen *çelësi i Broduejit*, e cila asokohe përdorej nga të rinjtë për të shënuar një bukuroshe, pa të cilën thuhet se nuk fillonte shëtitja mbrëmësore në atë rrugë. Kadareja vë në gojën e personazheve të veta shprehje të tilla, si *kriza e përgjithshme e kapitalizmit*, të cilën ata e shtinin në punë për një mikeshë të tyren që vinte e dobët nga shtati, *luledielli* për një vajzë bionde me quka në fytyrë, ose *His have a hall* dhe *I have a hall*¹⁸, çka ngjan me një përzierje kodesh anglisht e shqip, por, në të vërtetë, nuk është e tillë në të dyja rastet. *His have* është një ndërtim i pakuptimtë në anglisht, sepse te *His* kemi një përemër pronor që nuk mund të bashkohet me një folje. Po që se ndërtimi do të kishte një trajtë si: *He has a hall*, atëherë, po, do të kishim të bënim vërtet me përzierje kodesh si ajo që hasim në rastin e dytë, i cili në shqipe do të tingëllonte pak a shumë *unë kam një hall*. Më duket e pathemeltë edhe hamendja se mund të kemi të bëjmë me një *lapsus calami* të autorit ose

¹⁶ Edgar Radtke, art. i cit., f. 23-24.

¹⁷ Edgar Radtke, po aty, f. 24.

¹⁸ Shih Ismail Kadare, *Dimri i vetmisë së madhe*, Shtëpia botuese “Naim Frashëri”, Tiranë, 1973, f. 205-207.

me një gabim shtypi, sepse ndryshimi mes formave *his have* dhe *he has* është shumë më i madh se ai që mund të përlicqej me një gabim të bërë pa dashje. Pra, loja e autorit është e qëllimtë dhe synon arritjen e efekteve të caktuara stilistike.

Dëshmia tjetër lidhet me faktin se në ligjërimitin e sotëm studentor ndeshen jo pak njësi që janë përdorur nga studentët e UT-së edhe para viteve '90. Ish-studentët nuk e kanë aspak të vështirë t'i shquajnë 'prodhimet e tyre', sepse ato shpesh kanë ruajtur po atë kuptim. Megjithatë njëri nga tiparet që i dallon ligjërimitin rinorë prej varianteve të tjera është efemeriteti i elementeve, nuk mungojnë edhe rastet kur ato (njësitë) duken me të vërtetë jetëgjata. Është e vështirë të përcaktohet me saktësi se kur kanë nisur të përdoren si njësi të ligjërimit studentor fjalët *dor(ë)*¹⁹, *garip*, *gom(ë)*, *urithat*²⁰, *Korpusi*, *Kollonat*, *Filoqyli*, *Peshkopati*, *peshkop*, *kalec*, *fuks* etj., por nuk ka dyshim se ato datojnë para viteve '90 dhe se janë përcjellë me një lloj fanatizmi nga një brez studentësh të tjetri. E kam fjalën për ato njësi që mund të përfillen si *lema konstante*, term me të cilin unë do të quaj pikërisht ato elemente të ligjërimit studentor që janë krijuar kohë më parë e që vazhdojnë të përdoren ende prej studentëve. Disa nga këto, si për shembull *garip*, *dor(ë)*, *gom(ë)* me kohë i janë kthyer gjuhës së përbashkët, e pikërisht atij regjistri që njihet si ligjërimiti bisedor, por ky lloj dyzimi nuk i bie ndesh hipotezës sime, nëse do të jem në gjendje të tregoj kahun e vër-

¹⁹Pjesa më e madhe e njësive të ligjërimit studentor që ndeshen në këtë punim vjen prej anketimit që unë kam zhvilluar me 66 studentë të Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë (dega Gjuhë e Letërsi Shqipe, viti IV), si dhe të Gjuhëve të Huaja (në degët Turqisht e Anglisht, viti I) më 2005. Modeli i pyetësorit ku përfshihen 177 njësi dhe rezultatet e tij jepen në paragrafin e dytë të pjesës së dytë. Njësitë janë shënuar ashtu siç i kam dëgjuar nga goja e studentëve, pavarësisht se në ndonjë rast rregullat e drejtshkrimit do ta donin ndryshe.

²⁰Kjo njësi që në thelb është një metaforë, shënonte në krye studentët e Fakultetit të Inxhinierisë së Minierave, më pas, me anën e një kapërcimi metonimik, nisi të përdoret edhe për vetë fakultetin. Kur të bëhet fjalë për rastin e fundit, do të shënohet me shkronjë të madhe.

tetë të lëvizjes së njësive. Mjaft interesant paraqitet në këtë këndvështrim rasti i fjalës *garip*. E huazuar prej turqishtes, ku ka kuptimin ‘i çuditshëm’ dhe vlerë mbiemërore, ajo hyri në shqipen bisedore për të treguar ‘një njeri të vetmuar’, ‘njeri pa njeri’ ose ‘shkretan’. Në ligjërimet tona rinore kjo fjalë ka shënuar që në krye ‘një djalë të hedhur e të shoqërisë’²¹. Më pas do të përdorej kryesisht me vlerën që i patën dhënë rioshët, kështu që kuptimi i dytë antonimik e ka errësuar thujse krejt të parin, me të cilin edhe në ligjërimin bisedor mund ta hasësh fort rrallë, te ndonjë i moshuar.

Po t’i këqyrim më nga afër ato që unë i quajta *lema konstante*, do të vërejmë se një pjesë e tyre përbëhet nga mikrotoponime të rëndësishme për jetën e studentëve: *Korpusi*, *Kollonat*, *Peshkopati*, *QS-ja*, *Libri universitar*, *Blloku*, *Piramida*, *Fusha e Begsave*, ndonëse ndonjë shok i tyre, jo më pak i rëndësishëm, si *Pallati i Dimrit* (pas gjasave, për shkak të vështirësisë në marrjen e provimeve), me të cilin deri në mesin e viteve ‘90 kuptohej godina e Fakultetit të Shkencave të Natyrës, sot nuk po dëgjohet më; emërtime fakultetesh dhe shkollash të tjera të larta ose jo, si: *Filoqyli*, *Gjuhët e huaja*, *Ekonomiku*, *Artet*, *Liceu*, *Shkencat*, *Urithat*, *Instituti*, *Akademia*, *Petro Nini*, *Polikumi*, *Samiu*, *Shkolla e Begsave* etj. Një nënklasë të tretë të kësaj kategorie do ta përbënin apelativët për mësimdhënësit, “të pandryshueshmet” *presor* e *zysh*, gjegjësisht trajta të shkurtuara të fjalëve profesor e zonjushë (nga ky rregull bëjnë përjashtim vetëm studentët e ardhur nga Shkolla e Mesme Pedagogjike e Elbasanit, të cilët, nën ndikimin e traditës që krijoi Normalja, janë mësuar t’u drejtohen mësimdhënëseve me *zoj/a* – *zonjë/a*). Po këtu do të përfshija edhe dy njësi të tjera, siç janë *kandidat(e)* e *praktikant(e)*, që shënojnë kandidatin për mësues ose atë që

²¹ Me trajtën e femërorizuar *garipe* përdoret edhe për vajzat. Shih edhe Ilda Strori, *Njësi efemere në ligjërimin e studentëve*, temë diplome e mbrojtur nën drejtimin tim pranë Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë, Universiteti i Tiranës, viti akademik 2002-2003.

kryen praktikën mësimore, prej të cilave të parën e përdorin vetëm studentët e ardhur nga shkollat e mesme të Tiranës e të Elbasanit, ndërsa të dytën të gjithë ata që vijnë nga rrethet e tjera. Edhe njësitë *jam me sezon, kam një firmë, dhashë një shlyerje, kaloi në stazh, më këputi, e lashë për vjeshtë, vjeshta e vogël, e kam të mbartur*, të cilat emërtojnë dukuri që lidhen përjashtimisht me jetën e studentëve, e që në këtë kuptim u afrohen më shumë fjalëve-terma, unë do t'i klasifikoja pa pasur frikë se po gaboj te *lemat konstante*.

Nga ana tjetër, këto njësi nuk duhen ngatërruar me *lemat flamur*. Me këto të fundit unë kuptoj ato elemente përmes të cilave përpiqet të vetidentifikohet çdo brez studentësh. Nisur nga ky përkufizim kuptohet se janë ato njësitë që në një çast të dhënë marrin përsipër të luajnë rolin kryesor në dallimin e këtij entiteti prej varianteve të tjera të repertorit. Është e natyrshme që këto elemente të kenë prestigjin më të madh e, pikërisht për këtë arsye, edhe frekuencën më të madhe të përdorimit. Falë prestigjit e dendurisë ato do të luajnë një lloj funksioni unifikues e simbolik, duke e njëtrajtësuar për aq sa munden sjelljen gjuhësore të studentëve dhe duke u identifikuar në terma të perceptimit me krejt ligjërimit studentor, kur në të vërtetë janë vetëm një pjesë e tij. Prej të njëjtit përkufizim mund të rrokët edhe një tipar tjetër i tyre, e pikërisht ai që ka të bëjë me efemeritetin. Çdo brez studentësh, “i pakënaqur” me atë që trashëgon, është i prirur të hedhë në qarkullim *lemat* e tij *flamur*. Në këtë pikë ato ndryshojnë prej *lemave konstante* të cilat janë më jetëgjata. Mund të ndodhë shpesh që *lemat flamur*, ndër të cilat, sa për të dhënë ndonjë shembull nga këto të sotmet, po përmendim: *çau, i fortë, hë grup, ec të vdeksha, s'ma ndjen fare, tung* të shndërrohen në *lema konstante*, por jo e anasjellta. Që të dyja këto kategori bëjnë pjesë të ashtuquajturat *konstante gjuhësore*, sepse çdonjëra prej tyre në mënyrën e vet e ndihmon procesin e dallimit të këtij entiteti prej të tjerave.

Kjo nuk do të thotë se i tërë fondi leksikor i ligjërimit studentor

i nënshtrohet nga kjo pikëpamje një klasifikimi binar. Ka jo pak njësi që nuk mund të përfshihen në asnjërin prej grupeve që përmenda. Ato i takojnë një shtresimi të tretë, e meqë zakonisht janë më jetëshkurtra se të tjerat dhe karakterizohen nga një denduri më e vogël përdorimi, unë po i quaj *lema virtuale*. Në një këndvështrim tjetër, të gjitha njësitë që shfaqen në një çast të dhënë në ligjërimin studentor janë potencialisht *lema virtuale*, vetëm disa syresh mund të kthehen në *lema flamur*, të tjerat bien shpejt në harresë.

Prania e këtyre shtresimeve brenda fondit leksikor të ligjërimin studentor më shpie tek ideja se ai pjesërisht është produkt i përvojës sonë gjuhësore, d.m.th. i asaj që ne kemi mësuar nga të tjerët (*lema konstante*) dhe pjesërisht i asaj që kemi mundur të krijojmë vetë (*lema virtuale* dhe *lema flamur*). Thënë ndryshe, duke iu drejtuar një terminologjie më ortodokse se ajo që kam përdorur unë, edhe ligjërimi studentor, sado e habitshme që të duket, është shprehje e atij ekuilibri të ndërliqshëm mes konformizmit dhe individualizmit në gjuhë²². Ndonëse më duket se e kam shpjeguar, së paku në parim, psenë e ekzistencës së tri shtresimeve që përmenda më lart, ende nuk kam thënë asgjë për arsyet që i shtyjnë përdoruesit e këtij entiteti të zgjedhin disa prej njërive “të vjetra” për t’i kthyer në *lema konstante*, ndërkohë që i flakin tej të tjerat. Për ç’arsye mbijetoi ta zëmë *garip* dhe u harrua *shkrepe suedeze*? Mendja ta do që *lema flamur* të kenë shanse më të mëdha se të tjerat për t’u kthyer në *konstante*, por edhe kjo nuk i mbyll të gjitha shtigjet. Sa për rastin që mora si shembull, do të thosha se *shkrepe suedeze* lindi dhe u përdor në atë kohë kur seksi mes të rinjve të palidhur me martesë dënohej nga opinioni si diçka e pamoralshme, ishte një tabu, e për këtë arsye edhe profilaktikët që përdorin meshkujt, prezervativët, meritonin një eufemizëm; sot që seksi nuk konsiderohet

²² Shih Richard Hudson, *Sociolinguistica*, Società Editrice il Mulino, Bologna, 1990.

më i tillë, *shkrepse suedeze* s'ka pse ekziston. Prandaj më duket e udhës që krahas përpjekjeve për ta ndriçuar dukurinë në tërësi, kur e lyp nevoja, t'i drejtohem edhe analizës së rasteve të veçanta.

Nga sa thashë merret vesh që ligjërimet rinore duhet të kenë qenë pjesë e shqipes së folur edhe para viteve nëntëdhjetë, ndonëse ato nuk e kanë tërhequr vëmendjen e specialistëve. Shkaqet e kësaj “harrese” duhen kërkuar së pari te përparësitë e gjuhësisë shqiptare me mbarrimin e Luftës së Dytë Botërore. E këtu kreun e vendit me të drejtë do ta zinte njësimi i gjuhës së shkruar e të folur²³ dhe institucionalizimi i variantit normativ, për përmbushjen e të cilave do të punohej me ngulm deri në fillim të viteve '90.

Kjo politikë gjuhësore njësuere, që nisi të bëhet mbizotëruese nga viti 1952 e këtej, si dhe marksistizimi gradual i mendimit shkencor zyrtar brenda caqeve të Shqipërisë politike, nuk mund ta ndihmonin përfitim edhe ndër ne të një këndvështrimi sociolinguistik ndaj realitetit gjuhësor. Për mungesën e një vetëdijeje të tillë flet edhe ky pohim i prof. Shkurtajt, njërit prej dialektologëve tanë më në zë, me ndihmesa prej pionieri edhe në sociolinguistikë, sipas të cilit, «...ajo [sociolinguistika] kishte hyrë tashmë nga dritaret [por ne nuk e dinim] tamam në çastin e duhur, kur ne po mateshim t'ia hapnim apo jo derën [në vitet '90]»²⁴.

Por qasja sociolinguistike bëhej edhe më e vështirë ngaqë ajo implikonte drejtpërdrejt edhe “çështjen e karakterit klasor të gjuhës” dhe të qenies së saj ose jo superstrukturë, të cilat qenë shndërruar në tabu pas trajtimit që i bëri Josif Visarionoviçi kur pati rrëzuar tezat e

²³ Shih *Drejtskrimi i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1973, f. 21.

²⁴ Gjovalin Shkurtaj, *Sociolinguistika*, SHBLU, Tiranë, 1996, f. 8.

²⁵ Shih Stalin, *Marksizmi dhe çështjet e gjuhësisë*, Shtëpia botuese “8 Nëntori”, Tiranë, 1979.

Marrit në faqet e “Pravdës”²⁵. Vetë Stalini në krye, duke e konceptuar gjuhën thjesht e vetëm si një mjet komunikimi, *ia mbyll derën* studimit të variacionit diastratik, meqë i konsideron zhargonet si shfaqje të degradimit të gjuhës kombëtare²⁶. Por, për hatër të së vërtetës, duhet thënë se më pas ai u tregua aq i kthjellët sa të pranonte që, edhe pse gjuha nuk ka karakter klasor, përdorimi i saj ka: «Thamë më sipër se gjuha, si mjet komunikimi midis njerëzve në shoqëri, u shërben njësoj të gjitha klasave të shoqërisë dhe në këtë drejtim tregon njëfarë indiferece kundrejt klasave. Por njerëzit, grupet e ndryshme shoqërore dhe klasat nuk janë aspak indiferente kundrejt gjuhës.

Ata përpiqen ta përdorin gjuhën në interes të vet, t’i imponojnë asaj fjalorin e vet të veçantë, termat e vet të veçantë»²⁷. Duket sheshit se kemi të bëjmë me një pohim që e përlligj si diçka të natyrshme ekzistencën e sociolekteve, duke pranuar tërthorazi dhe rëndësinë e studimit të tyre.

E vërteta është se edhe atje ku nuk ka munguar qasja sociolinguistike ndaj realitetit gjuhësor dhe kushtet për të cilat bëra fjalë më lart janë plotësuar më së miri, ka studiues që nuk pajtohen me ekzistencën e ‘ varianteve ’ rinore të gjuhës. I tillë është rasti i prof. Tulio de Mauros, sipas të cilit, ligjërimi rinor nuk është gjë tjetër veçse «një fantazmë e krijuar nga mediat dhe nga ndonjë studiues që kur është i ngeshëm zbatimet duke i dhënë trup [...] *si çdo bashkimi që ka njëfarë qëndrueshmërie në kohë e njëfarë peshe*, (korsivi është i imi. A.D.) edhe grupeve të të rinjve u jepet mundësia të përftojnë tipare stilistike dhe fjalë të veçanta [...] shembujt e fjalëve të përdorura nga të rinjtë janë gjithmonë një përzierje mes shprehjesh, ndoshta dialektore, që, në të vërtetë, i përdorin edhe të rriturit dhe *fjalësh me qarkullim të kufizuar, të cilat*

²⁶ Po aty, f. 9.

²⁷ Po aty, f. 14.

kuptohen vetëm nga grupe të vogla të rinjsh [...] do të thosha se vetëm në një aspekt ka kuptim të flitet për gjuhën e të rinjve: gjuha e tyre është italishtja atje ku ajo e prindërve të tyre ishte dialekti»²⁸. I një mendjeje me të duket se është edhe Simone që shkruan: «...në qoftë se e shohim nga afër, gjuha e të rinjve është një objekt që nuk ekziston, një panterë e vërtetë kutërbuese: gjendet kudo, ia ndien praninë, por nuk e zë dhe as e fotografon dot. Ndryshime të thella e thërrmojnë vetë konceptin: ka të rinj të shkolluar dhe analfabetë, të pasur, në gjendje të mirë dhe të varfër; jugorë, qendrorë e veriorë; qytetarë e fshatarë; janë të rinjtë rruçaçë dhe ata për së mbari; të çoroditurit dhe të rregulltit, të politizuarit dhe naivët etj., e nuk mund të thuhet se kanë të njëjtën gjuhë. Në të vërtetë, kur bëjmë fjalë për ligjërimin e të rinjve aludojmë pa e kuptuar thujtë vetëm për atë të borgjezisë së vogël qytetare deri diku të shkolluar e të mbushur me mllef ndaj të rriturve. E trajtojmë borgjezinë e vogël qytetare si emblemë të një brezi të tërë [...]. Këta të rinj shfaqin një prirje të fuqishme kah zhargonizmi, d.m.th. nga përdorimi i fjalëve që bota e jashtme nuk i di dhe as i njeh si të vetat. E bëjnë për t'u ndier solidarë dhe për të shenjuar përkatësinë e tyre në një grup... Gjuha e tyre është e papeshë si një re: meqë njeriu mund të jetë i ri për dy ose tre vjet, vetëm pak mjafton që gjithçka të ndryshojë: ai që e mban mend, fjala vjen, zhargonin e paninarëve, madje edhe ligjërimin arki-politik të '68-ës, sot do të ishte i pakuptueshëm. Ky ligjërim në dukje kriptik, në të vërtetë është i një tejdukshmërie të madhe, sepse rregullat e tij janë po ato të më të përhapurve *rhyming slang*, të gjuhëve që bëjnë për të qeshur dhe që përdoren në gjysmën e botës. Për këto arsye

²⁸ Cituar sipas Marta Maddalon e Fabio Bianco, *Aspetti dell'Italia linguistica: analisi di una porzione di lessico giovanile (Cosenza) a confronto con un repertorio generale italiano* në Quaderni del Dipartimento di Linguistica, 16, Serie linguistica 7, Università della Calabria, f. 167.

²⁹ Po aty, f. 167.

jam i bindur që gjuha e të rinjve nuk është as e rrokshme si objekt studimi dhe as e rëndësishme si dukuri shoqërore»²⁹.

Të dy këta studiues e vënë në pikëpyetje ekzistencën e ligjërimeve rinore nisur nga këndvështrime të ndryshme.

I pari, prof. De Mauro, duke i quajtur grupet e të rinjve bashkime që kanë njëfarë qëndrueshmërie në kohë e njëfarë peshe, u njeh atyre të drejtën të përftojnë tipare stilistike dhe fjalë të veçanta, por, nga ana tjetër, shton edhe që të kështuquajturat ligjërime rinore nuk janë asgjë tjetër përpos një përzierjeje shprehjesh dialektore që, në të vërtetë, i përdorin edhe të rriturit, dhe disa fjalëve me qarkullim të kufizuar. Po ta këqyrësh me kujdes, mohimi që prof. De Mauro u bën ligjërimeve rinore nuk është aq kategorik sa ç' mund të duket në pamje të parë. Ai fare mirë mund të përkthehet në një problem statusi, në kuptimin më të gjerë të fjalës: veçoritë ekzistokan, çështja është në duhet t'u njohim atyre statusin e një entiteti të dallueshëm, apo do t'i trajtojmë thjesht si tipare? Edhe më e qartë bëhet kjo po të mbajmë parasysh ato që prof. De Mauro i quan fjalë me qarkullim të kufizuar, duke pranuar se ato përdoren vetëm nga të rinjtë e duke aluduar edhe për karakterin e tyre kriptik.

Ndryshe qëndron puna me Simonen, i cili, duke dashur ta kapë demin për brirësh, ngre së paku tri probleme: a) të rinjtë nuk përbëjnë një grup shoqëror homogjen; b) kur bëhet fjalë për gjuhën e të rinjve gabimisht aludohet thjesht e vetëm për gjuhën e të rinjve nga radhët e borgjezisë së vogël qytetare dhe c) meqenëse këto njësi janë jetëshkurtra, ato nuk mund të kenë kurrfarë rëndësie, aq më tepër që u mungon edhe origjinaliteti, sepse u binden disa modeleve që i përdor gjysma e botës. Në të njëjtën kohë ky studiues nxjerr në spikamë edhe disa tipare të sjelljes gjuhësore të të rinjve, si fjala vjen prirjen për zhargonizëm.

Fakti që të rinjtë nuk përbëjnë një grup shoqëror homogjen, ngaqë ata vijnë prej visesh të ndryshme, nga shtresa të ndryshme, me nivele të ndryshme shkollimi e kështu me radhë është i njohur prej të

gjithëve, por ai nuk e përjashton mundësinë që brenda kësaj laryshie që ngërthen 14 – 22-vjeçarët, me fjalë të tjera paraadoleshentët, adoleshentët dhe pasadoleshentët³⁰, të dallohen grupe të veçanta pak a shumë homogjene, në të cilat të përftohen jo një, por disa ligjërime rinore; a nuk bën fjalë edhe vetë Simone për gjuhën e të rinjve nga radhët e borgjezisë së vogël qytetare, deri diku të shkolluar? Që këtej del se tek e fundit një grup të rinjsh që paska ‘gjuhën e vet’ ekzistoka edhe për të.

Për sa i takon problemit të tretë, atij që ka të bëjë me jetëshkurtesinë e njësive dhe me mungesën e origjinalitetit, mund të thuhet se është pikërisht efemeriteti i njësive ai që i bën këto entitete më të gjalla se të tjerat, ndërsa ajo që Simone e percepton si mungesë origjinaliteti tregon karakterin universal të dukurisë, çka, sipas meje, e bën edhe më të rëndësishme.

Megjithatë, edhe ata që e pranojnë në parim ekzistencën e ligjërimit të studentëve janë të shtrënguar t’u përgjigjen së paku tri pyetjeve: 1) a përbëjnë studentët me të vërtetë një grup shoqëror? 2) a mund të jemi të sigurtë se njësitë e ligjërimit studentor përdoren vetëm nga ata dhe nga askush tjetër? 3) çfarë e prodhon tek e fundit këtë ligjërime? Nuk është aspak e lehtë t’u përgjigjesh këtyre pyetjeve e, për fat të keq, nuk mjafton as edhe ndonjë përgjigje njërrrokëshe me *po* ose *jo*. Gjithsesi besoj se do të ishte më e udhës që, më parë se të gjykonim nëse studentët e Universitetit të Tiranës përbëjnë ose jo një grup shoqëror të veçantë, t’i drejtoheshim vetë konceptit, i cili, me sa duket, ka fatin e keq të gjërave “të thjeshta”. Sipas Gurviçit, «...grupi është një njësi kolektive reale, por e pjesshme, e vëzhgueshme drejtpërsëdrejti dhe e mbështetur në qëndrime kolektive të vazhdueshme e aktive, me punë që duhen kryer së bashku; një unitet qëndrimesh, veprimesh e

³⁰ Pikërisht për këtë grupmoshë (18 – 22) vjeç e kam fjalën unë kur u referohem studentëve.

sjelljesh, struktura e të cilit është e orientuar nga një ekuilibër i veçantë i formave të shoqërueshmërisë»³¹. Po t'i zëmë besë këtij përkufizimi që si elemente të kohezionit brenda grupit mban misionin e përbashkët, qëndrimet, veprimet dhe sjelljet e përbashkëta, ku pa dyshim bën pjesë edhe sjellja gjuhësore, si pasojë e një ndërveprimi verbal të vazhdueshëm mes pjesëtarëve, atëherë pesha e heterogjenitetit të prejardhjes gjeografike, shtresore, fetare etj., relativizohet mjaft. Për Marino Livolsin «... të rinjtë e sotëm shndërrohen në një 'grup shoqëror' jo aq për faktin se ndajnë vlera të përbashkëta ose një pozicion shoqëror të caktuar, sesa për faktin që ata aderojnë në disa 'stile' të caktuara jete-se, pra për disa mënyra të të kuptuarit të vendit të tyre në shoqëri. Një pozicionim i tillë buron prej faktit se të rinjtë kanë një projektim të tyre të shoqërores, si vizion i gjërave që duhen bërë, i sjelljeve që u kërkohen [të cilat lipset të jenë] ose më të dobishmet, ose më të volitshmet»³². Të tjerë studiues brenda kategorisë 'virtuale' të njohur si *të rinjtë* dallojnë *peer group*-et dhe *grupet e subkulturave*. Megjithatë, në rastin e studentëve besoj se jemi më afër së vërtetës, në qoftë se flasim për një shumësi mikrogrupesh a për një mozaik të tillash brenda së tërës, për të cilat ligjërimi studentor kthehet në një faktor unifikues.

Përgjigjja e pyetjes së dytë kushtëzohet nga marrëdhëniet që vendosin entitete të këtij lloji me gjuhën e zakonshme e me njëri-tjetrin, posaçërisht nga shkalla e ndryshme e hapjes që kanë ato mes vedi dhe kundrejt saj. Gaetano Berruto është i mendimit se «një problem i rëndësishëm i kërkimeve mbi arkitekturën e gjuhës lind prej mbivendosjes së varianteve, e cila i detyrohet faktit që mjaft elemente nuk i përkasin vetëm këtij ose atij varianti të gjuhës, por shfaqen në shumë

³¹ Cituar sipas Jean Baptiste Marcellesi dhe Bernard Gardin, *Introduzione alla sociolinguistica*, Laterza & Figli, Bari, 1979, f. 10.

³² Marino Livolsi e Ivano Bison, *Una lettura dei dati: alcune ipotesi interpretative*, në *Il linguaggio giovanile degli anni novanta*, botuar nën kujdesin e Emanuele Banfi-t dhe Alberto Sobrero-s, Laterza & figli, Bari, 1992, f. 150.

prej tyre, duke u diferencuar falë frekuencës me të cilën dalin në tekstet përfaqësuese të secilit variant...»³³. Pra, për këtë studiu, ekskluziviteti i përkatësisë së elementeve në përkufizimin e varianteve duhet t'ia lërë vendin frekuencës më të madhe të përdorimit të të njëjtave elemente në këtë ose atë variant, sepse elementet me të vërtetë diagnostikuese janë shumë të pakta.

Ligjërimi studentor nuk është një gjuhë e veçantë në raport me gjuhën e përbashkët, ai përfaqëson një përpjekje për ta ripërpunuar në një mënyrë tjetër atë lëndë gjuhësore që është pronë e gjithë bashkësisë. Në këtë kuptim edhe ligjërimi studentor, njësoj si entitetet e tjera simotra, mund të konsiderohet si një 'gjuhë' parazitare që ushqehet me fjalë e gjedhe fjalëformuese prej asaj së zakonshme. Në këtë mënyrë rivërtetohet edhe për gjuhën po ajo tezë që nuk i njeh kulturës rinore një status autonom në raport me kulturën sunduese, por vetëm atë të një elementi të varur, paçka se pjesërisht të ndryshëm. Unë jam i mendimit që ligjërimi studentor krahasuar me entitetet e tjera rinore është më i hapur ndaj gjuhës së zakonshme, ngaqë studentët përpiqen të dallohen gjuhësisht prej të tjerëve dhe jo të veçohen nga ata. Po ashtu, falë prestigjit më të madh që gëzon, ky entitet ndikon më fort se të tjerët mbi gjuhën e përbashkët. Prandaj mund të ndodhë që, jo vetëm kur dalin nga përdorimi në ligjërimin studentor, por edhe ndërkohë që gjallojnë ende në të, disa prej njësive të tij t'i hasësh në gjuhën e zakonshme³⁴. Në këtë kuadër është bërë fjalë edhe për një kompleks të çuditshëm edipik të ligjërimin studentor ndaj gjuhës së përditshme, çka duhet kuptuar pak a shumë kështu: *e di, jam biri yt, por jam më i zoti se ti, sepse jam më i gjallë, më shprehës e, ç'është më e rëndësishmja, më modern se ti*. Prandaj ligjërimi studentor mund të mendohet si pjesë e së tërës, si një

³³ Gaetano Berruto, *Prima lezione di sociolinguistica*, Editori Laterza, Roma-Bari, 2004, f. 96.

entitet ‘i paqëndrueshëm’ dhe dinamik, i cili sa më shumë përpiqet të shndërrohet në një mjet komunikimi mbidialektor, aq më shumë humbet në terma të shprehësisë, aq më shumë ‘shteknicizohet’, duke lehtësuar kësisoj kalimin e leksikut dhe të shprehjeve metaforike në gjuhën e zakonshme. Me fjalë të tjera, ligjërimi studentor sa më shumë rritet, aq më shumë kthehet te ‘nëna’, por kësaj radhe për të dhënë e jo për të marrë.

Para se t’i përgjigjem pyetjes së tretë jam i shtrënguar t’u kërkoj ndihmë dy filozofëve. I pari, Vitgenshtajni, thotë se «Realiteti, edhe ai ligjërimor është tërësi marrëdhëniesh, jo objektësh»³⁵. Ndërsa i dyti, Hajdegeri, duke iu drejtuar studentëve të tij të kursit të filozofisë të vitit 1951 – 1952 shprehet: «... Njëra prej karakteristikave të dhunës në rritje të mendimit të njëbinarshëm, krejt i jashtëm në pamje të parë, është përhapja e madhe që kanë pasur kudo ato emërtime që konsistojnë në shkurtimin e fjalëve ose në përdorimin e nistoreve. Ka të ngjarë që asnjë nga të pranishmit të mos e ketë marrë ende seriozisht në konsideratë domethënien e asaj që ka ndodhur tashmë, kur ata vetë, në vend që të thonë *Universität*, thonë thjesht *Uni*. *Uni* është si *kinema*. Në të vërtetë, salla ku projektohen filmat mbetet një gjë krejt tjetër nga shkolla e lartë e shkencave. Megjithatë, emërtimi *Uni* nuk është as i rastit dhe as i patëkeq. Ndoshta bën pjesë në atë rend gjërash, sipas të cilit ata dalin nga *Uni* dhe futen aty, ata marrin hua libra në *UB* [Biblioteka e Universitetit]. Problemi i vetëm është të dihet cili rend [gjërash] e ndihmon përhapjen e këtij ligjërimi. Ndoshta është një rend gjërash nga i cili ne jemi tërhequr dhe e kemi lënë veten të tërhiqemi, për shkak të asaj që na josh»³⁶.

³⁴ Shih për këtë më lart.

³⁵ Ludwig Wittgenstein, *Tractatus Logico-philosophicus*, Oxford, 1989, af. 1.1.

³⁶ Martin Heidegger, *Che cosa significa pensare?*, përkthimi i U. Ugazio-s, Sugarco Edizioni, Milano, 1996, f. 117-118.

Është thënë në më shumë se një rast se ligjërimet rinore (edhe atë studentor) i lind revolta e të rinjve ndaj 'botës së etërve', i lind ajo prirje normale, thuajse fiziologjike në adoleshencë e pasadoleshencë për të mos iu bindur rregullave që i kanë vendosur të tjerët. Kuptuar kështoj edhe ligjërimi studentor është njëra nga shfaqjet e asaj përplasjeje të madhe me një univers vlerash që bartësit e tij i ndiejnë si të huaja e ndaj të cilave nuk janë në gjendje të reagojnë me mjetet e kritikës së shëndoshë. Përveç kësaj ligjërimin studentor e lind nevoja për vetafirmim, nevoja për të shpallur disa vlera të tjera që lipset të marrin qytetarinë dhe që gjuha e zakonshme, po sipas bartësve të tij, është e paaftë t'i shprehë.

Shkaqet që shpiten në lindjen e ligjërimin studentor bëhen më të prekshme po t'u drejtohem funksioneve që përmbush ai:

Identifikimi me grupin dhe pohimi i identitetit vetjak. Ligjërimi studentor u shërben bartësve të tij për t'u identifikuar me këtë takëm të zgjedhurish që e shohin veten më lart se shumëkush brenda caqeve të shoqërisë sonë të sotme. Shtënia e tij në punë përbën pra një përpjekje për t'u dalluar nga pjesa tjetër e shoqërisë. Por ajo është edhe një shenjë e shkëputjes prej varësisë që i riu ka përjetuar deri në këtë çast. Prandaj ligjërimi studentor luan një rol jo të vogël edhe në formimin e identitetit të individit, i cili gjen te shprehjet tipike të grupit instrumentet e nevojshme për të përcaktuar edhe identitetin e vet. Për pasojë ai është i prirur t'i përdorë këto forma verbale edhe jashtë kornizave të mikrogrupit ku bën pjesë.

Përcjellja e emotivitetit. Racionalitetit që rreket ta sundojë gjuhën e zakonshme ligjërimi studentor i kundërvë emotivitetin duke u bërë kështoj shkak që t'i kthejmë sytë edhe një herë nga kjo përmasë e rëndësishme e të folurit. Një gjë e tillë e gjen shprehjen e vet më të zakonshme në përdorimin e dendur të tingullimitimeve, të pasthirmave, të figurave retorike, të mimikës dhe të referimeve hapësinore që shoqërojnë mjaft prej shprehjeve të ligjërimin studentor. Gjestet

mimika, muzika, kërcimi, veshja dhe *look-u*, që të gjitha i shërbejnë trupëzimit të emotivitetit. Më shumë se për një gjuhë ‘të varfër’ fjala është për një gjuhë ‘të përshpejtuar’ që rreket ta zvogëlojë largësinë mes atij që flet dhe atyre që dëgjojnë, me qëllim që t’i implikojë emocionalisht këta të fundit. Këtij qëllimi i shërben edhe *vizualizimi i fjalës*. Ky shfaqet edhe më qartë në përdorimin e dendur të ligjërimit joverbal nga ana e studentëve. Për sa u takon tingullimitimeve dhe pas-thirmave në ligjërimitin e sotëm studentor, kam vënë re se ato të brumit të shqipës po përdoren gjithnjë e më rrallë. Vendin e tyre e kanë zënë huazimet nga gjuhë të tjera, kryesisht prej italishtes e anglishtes, si për shembull *bla-bla-bla, ups, opla, uau*. E njëjta gjë ka ngjarë edhe me gjestet, si me ato që zëvendësojnë fjalë, ashtu dhe me ato që shoqërojnë fjalë. Po jap vetëm fare pak shembuj: gishti i madh i ngritur lart në dorën e mbledhur grusht me kuptimin ‘mirë, në rregull, dakord’, kur dihet mirëfilli se për shqipfolësit i njëjti gjest ka kuptim të kundërt, ‘hip këtu e shiko Stambollin’; dy gishta të dorës së djathtë, treguesi dhe ai i mesit të ngritur lart në formë V-je, me kuptimin ‘fitore’; gishti i mesit i ngritur lart dhe të tjerët të mbledhur bashkë me të madhin, me kuptimin ‘fuck you’; me një vlerë të përafërt shqipfolësit kanë përdorur një gjest tjetër, që e donte gishtin e mesit të përkulur përpara, në një lloj këndi të drejtë etj. E kundërta po ndodh me lëvizjet e kokës për të treguar pohimin ose mohimin, të cilat, me sa duket, do të na dallojnë edhe për shumë kohë prej evropianëve të tjerë.

Shoqërueshmëria. Parapëlqimi për shprehje që godasin, për kuptime të fshehura a gjysmë të fshehura e, sidomos, për fjalët e ndyra, që karakterizon ligjërimitin e pasadoleshentëve, shndërrohet rëndom edhe në një mjet përbashkues. Ai e ka zanafillën te *parulla* e grupit ose e mjedisit, e këtu, pa dyshim, një rol të veçantë kanë edhe *lemat flamur*. Përdorimi i fjalëve të ndyra ndikon në kompaktësimin e grupit, duke ndihmuar në krijimin e një klime konsensusi mes anëtarëve. Fjala e ndyrë, e thënë dhe e pranuar prej të gjithëve, nxjerr në pah forcën e gru-

pit. Pjesëtarët e tij çlirohen nga ndjenja e fajit që mund të sjellë me vete shkelja e tabuve. Por fjala e ndyrë e forcon grupin edhe atëherë kur përdoret kundër elementëve që mbahen si të huaj për të: e përdala, homoseksuali, handikapati etj. Të njëjtin funksion kanë edhe shprehjet e dhunës verbale kur u drejtohen të tjerëve.

Funksioni çlirues. Përdorimi joeufemistik i fjalës shpie edhe te çlirimi nga një tabu, ose nga një interpretim magjik i saj. I riu, në rruqen e tij drejt njohjes së realitetit dhe rrokjes së domethënies, provon më se një herë ta thotë vetmeveti atë fjalë dhe dikur e kupton që ajo nuk i sjell asnjë të keqe. Për këtë arsye mospranimi i ‘objektivitetit’ të fjalës në këtë rast tregon marrjen në zotërim të vetë gjuhës nga ana e folësit, administrimin e fjalëve dhe të kuptimeve të tyre ashtu siç ia merr mendja atij, duke qenë i çliruar prej vargonjve të traditës. Edhe pse është e vështirë të pranohet, nuk mund të fshihet fakti që thënia e një fjale të ndyrë përbën një akt me rëndësi shoqërore. Sipas Labovit, fjala e ndyrë në geto shërben si një mekanizëm për të shmangur ballafaqimin fizik³⁷. Madje ajo mund të shndërrohet në një ritual. Po ky autor bën fjalë për ‘sharjet rituale’. Gjatë kësaj sprove, në të cilën ballafaqimi mbetet verbal, lipset që protagonistët të gjejnë fjalët më therëse, sharjet më të rënda për ta mposhtur kundërshtarin. Fitues del ai që thotë ‘fjalën e fundit’³⁸. Uilliam Labovi Nensi Hastoni³⁹ e ndonjë tjetër e shohin *funksionin çlirues* në një këndvështrim paksa të ndryshëm. Për ta është e rëndësishme të kuptohet se përdorimi i fjalëve të ndyra ka një vlerë terapeutike e çliruese në masën që ato kthehen në një mjet për të jashtësuar ndjenjat më të thella. Këto ndjenja janë të lidhura ngushtë

³⁷ Shih William Labov, *Le parler ordinaire, la langue dans les ghettos noirs des Etats-Unis*, Les Editions de Minuit, Paris 1978, f. 23.

³⁸ Po aty.

³⁹ Shih Nancy Huston, *Dire et interdire, éléments de jurologie*, Payot, Paris 1980.

me ndrydhjen e akumuluar të përdoruesit e tyre. Këta të fundit shpesh ndiejnë nevojën ta thonë dhimbjen dhe zemërimin e vet. Në këtë kuptim *funksioni çlirues* nuk mund të ndahet me thikë prej *përcjelljes së emotivitetit*. Në një linjë me këta autorë duket se janë edhe ata psikanalistë, për të cilët bisedat me përmbajtje erotike dëshmojnë përpjekjen e individit për t'i sunduar, duke i fjalësuar, proceset e ndërlikuara psikike të lidhura zakonisht me seksualitetin, ku gjendet i mbërthyer rëndom adoleshenti dhe pasadoleshenti. Megjithatë, *funksioni çlirues*, i kuptuar kështu, do të ishte i mangët pa atë *zhvlerësues*, i cili më fort se me tabutë ka të bëjë me ato gjëra që për të tjerët (pra jo për studentët) kanë qenë e mbeten të rëndësishme⁴⁰.

Unë besoj se prania e ligjërimin studentor shpie te një lloj tjetër *bilinguizmi*, le të themi *rinor*, për më tepër i dyfishtë, që, ndryshe prej atij *dialektorit*, praninë e të cilit në shqipe e pati vërejtur së pari prof. Shkurtaç⁴¹, shfaqet në aftësinë për të kaluar nga dialekti në ligjërimin studentor ose prej këtij në shqipen standarde, duke e kthyer në këtë mënyrë ligjërimin studentor në një hallkë të ndërmjetme mes këtyre varianteve. Ky lloj substandardi, sipas meje, mund ta kryejë fare mirë këtë funksion, ngaqë, edhe pse nuk i ka humbur lidhjet me shqipen e zakonshme, është më pak i ndikuar se ajo prej dialekteve. Në të vërtetë, edhe Shkurtaç e çik tërthorazi këtë problem, kur në librin e tij *Etnografi e të folurit të shqipes* citon mes të tjerash nga punimi i diplomës së Baviola Shatros edhe një frazë të tillë: «... Në njëfarë mënyre ne flasim shumë më tepër gjuhë nga sa mund të mendojmë»⁴².

Edhe kur trajtova funksionet e ligjërimin studentor e zura ngoje prirjen e të rinjve ndaj zhargonizmit, por, siç mund të vihet re, i jam

⁴⁰ Shih më lart.

⁴¹ Shih Gjovalin Shkurtaç, *Sociolinguistika*, SHBLU, Tiranë, 1996, f. 9.

⁴² Shih Gjovalin Shkurtaç, *Etnografi e të folurit të shqipes*, SHBLU, Tiranë, 2004, f. 212.

shmangur përdorimit të termit zhargon dhe këtë e kam bërë me qëllim. Në literaturën shqipe mbi këtë çështje hasen rëndom dy terma, ligjërimi studentor dhe zhargoni i studentëve; aq dendur janë përdorur këta në vend të njëri-tjetrit, sa të krijohet përshtypja se janë sinonime. Marjana Ymeri në lidhje me situatën sociolinguistike para viteve '90 shkruan: «...jemi të mendimit që *elementet parazhargonore* (korsivi është i imi. A.D) të përdorura nga studentët (nuk është arritur asnjëherë në formimin e një zhargoni të vërtetë studentor dhe dëshmitë që sjell Q. Haxhihasani janë shfaqje sporadike, të kufizuara në kohë dhe hapësirë) nuk kanë pasur funksione të vërteta kriptike»⁴³, mandej po kjo studiuese shton «... duke pasur parasysh këto parametra ne kemi arsye të mendojmë që në Shqipëri *zhargoni studentor ekzistues* (korsivi është i imi. A.D) nuk ka qenë i tillë që të përbënte një mjet komunikimi midis studentëve në shkallë kombëtare dhe brenda një brezi të caktuar. *Zhargoni ekzistues* ka qenë modest, kalimtar i mbyllur»⁴⁴. Ndërsa për periudhën pas '90-ës Ymeri shprehet: «... Ky proces te ne filloi vetëm pas viteve '90, kështu që vetëm pas këtyre viteve, vërehen te ne *shfaqjet përkatëse të ligjërimit rinor* (korsivi është i imi. A.D) jo më të vetmuara dhe me një rreze të ngushtë përdorimi, por si një tipar në konsolidim e sipër i rinisë studentore»⁴⁵. Pa dashur të polemizoj me Ymerin, po ndalem vetëm te termat që ajo përdor për të shënuar atë “gjë” që shtien në punë studentët kur komunikojnë me njëri-tjetrin. Në krye ajo e quan ‘elemente parazhargonore’, pastaj ‘zhargon ekzistues’ (dhe e ka fjalën për të njëjtën periudhë) kurse më në fund ‘shfaqje përkatëse të ligjërimit rinor’. Konfuzioni terminologjik që zbulon edhe inkoheren-

⁴³ Marjana Ymeri, *Zhargoni dhe dëshmitë e tij në gjuhën shqipe*, në Gjuha jonë, 1-2, Tiranë, 2002, f. 25.

⁴⁴ Po aty, f. 30.

⁴⁵ Po aty, f. 33.

cën tregon gjithashtu edhe sa i vështirë është përkufizimi i këtij entiteti. Shkurtaj tregohet më i kujdesshëm kur thotë se: «Në gjendjen e derisotme të hetimit rreth këtij tipi të të folurit të shkollarëve, për të mos marrë përsipër etiketime të parakohshme e të pambështetura, ne po japim disa vëzhgime rreth ligjërit studentor, duke parashtruar disa tipare më të përgjithshme, mbi bazën e të cilave, edhe në mos guxofshim ta quajmë “zhargon studentor”, nuk kemi pse ta mohojmë se ekziston dhe se, mbi të gjitha, së paku meriton të hetohet më tej»⁴⁶. Edhe Berruto bën fjalë për *parazhargone*⁴⁷, por ai nuk e shtjellon më tej idenë e vet. Megjithatë, unë jam i mendimit që ligjërimi i studentëve dhe zhargoni studentor nuk janë shkallë të ndryshme në procesin e evoluimit të së njëjtës dukuri, siç lë të kuptohet Ymeri, por janë anë të ndryshme të saj. E, nga ana tjetër, besoj se studentët e Universitetit të Tiranës kanë prodhuar ligjërimi studentore, jo pse kanë qenë të pazotët të bëjnë diçka më “të mirë”, por sepse ato u janë dashur.

Fjala zhargon (që në shqipe ka të ngjarë të ketë hyrë prej frëngjishtes), vjen nga fjala e vjetër frënge *jargon*, me kuptimin ‘cicërima e zogjve’. Në italishten e vjetër thuhej *gergone*, në të sotmen *gergo*. Në anglisht përdoret më së shumti termi *slang*; në spanjisht *jerga*. Në *Fjalorin e termave të gjuhësisë (Slovar Lingvistiçeskij Terminov)* të Ahmanovës për zhargonin jepet ky përkufizim: «...Është gjuhë e përbërë nga elemente që zgjidhen, marrin forma të ndryshme dhe kombinohen në mënyrë arbitrare prej një a më shumë gjuhëve natyrore, e që përdoret zakonisht në komunikimin gojor nga një grup i veçantë shoqëror, me qëllimin për t’u veçuar gjuhësisht nga pjesa e tjetër e bashkësisë (nganjëherë me synime kriptike). Ndryshe nga argoja, zhargoni ka

⁴⁶ Gjovalin Shkurtaj, *Etnografi e të folurit të shqipes*, SHBLU, Tiranë, 2004, f. 212.

⁴⁷ Shih Gaetano Berruto, *Sociolinguistica dell’italiano contemporaneo*, La Nuova Italia Scientifica, Roma, 1990.

⁴⁸ O. C. Ahmanova, *Fjalor i termave të gjuhësisë*, Moskë, 1969, f. 148.

ngjyrim përkeqësues...»⁴⁸. Lidhur me argonë, e njëjta autore tregohet më e kursyer: «...është e njëjta gjë si zhargoni. Në dallim nga ai, argoja nuk ka ngjyrim përkeqësues...»⁴⁹. Ndërsa *Dictionnaire de linguistique* (Larousse), na jep një tjetër pamje: «Argoja, dialekt shoqëror që ka përfunduar në leksik me karakter parazitar (deri në atë masë që vetëm sa dublon me vlera afektive një fjalor ekzistues), e përdorur në një shtresë të caktuar shoqërore që e vendos veten në kundërvënie me të tjerët. Argoja ka për qëllim të kuptohet vetëm nga folësit e saj, ose të shënojë përkatësinë në një grup.

Argoja fillimisht përdorej nga keqbërësit (nga bandat e vjedhësve, të rrugaçëve). U zhvilluan të tjera argo në disa profesione (shitësit ambulantë) ose në disa grupe (shkolla, ushtri, të burgosur).

Disa profesione priren t'i dublojnë termat teknike me terma argotike. Të gjitha këto argo kanë të përbashkët mes tyre e ndonjëherë edhe me gjuhën popullore disa mënyra fjalëformimi (shkurtimin, prapshesimin parazitar, përmbysjen e rendit të tingujve ose të rrokjeve). Ato përdorin edhe mënyra kodimi... Së fundi, për të përtëritur fondin themelor leksikor argotë përdorin me qëllim figurën, zëvendësimin e sinonimeve të pjesshme dhe huazimet nga dialektet, ose, duke u dhënë shpesh termave një vlerë përkeqësuese, huazimet nga gjuhët e huaja me vlerë pejorative dhe e kundërta...»⁵⁰. Tek i njëjti fjalor hasim edhe këtë përkufizim: «Fillimisht zhargoni ka qenë një formë e argosë, e përdorur në një komunitet përgjithësisht marginal që ndien nevojën për të mos u kuptuar nga ata që nuk janë pjesëtarë të tij, ose që të dallohet nga e përgjithshmja (në këtë kuptim është folur për zhargonin e preciozeve). Duke u shtrirë zhargoni u përdor për të emërtuar një gjuhë që gjy-

⁴⁹ Po aty, f. 53.

⁵⁰ Jean Debois, Mathee Giacomo, Louis Guespin, Christiane Marcellesi, Jean-Baptiste Marcellesi, Jean-Pierre Mèvel, *Dictionnaire de linguistique* (Larousse), Paris, 1981, f. 47.

kohet si e deformuar, jokorrekte, e pakuptueshme: flitet kështu për zhargonin franglez, zhargonin e një nxënësi të keq ose për zhargonin e një filozofi...»⁵¹. Te *Dizionario di linguistica* për termin zhargon gjejmë këtë përcaktim: «Në përdorimin e zakonshëm e, nganjëherë edhe në atë të specialistëve, synohet që këtij termi t'i vishen kuptime të ndryshme; para së gjithash nga pikëpamja teknike me të duhet kuptuar një gjuhë konvencionale, e lidhur me një grup të përcaktuar shoqëror që e përdor me vetëdije në mënyrë kriptike për këto qëllime: a) dallimin prej të tjerëve; b) favorizimin e intimitetit në komunikimin e brendshëm duke forcuar kështu kohezionin mes anëtarëve të grupit; c) fshehjen e mesazhit për ata që nuk bëjnë pjesë në grup. Për rrjedhojë ky term ka pësuar një shtrirje dhe ka marrë kuptime më përgjithësuese, të tilla si 'mënyrë ose stil i të folurit', 'sektor i fjalorit tipik të një klase ose profesioni të caktuar (ku karakteri enigmatik nuk është i qëllimshëm e shpesh herë as edhe i vetëdijshëm) ose 'mënyrë e errët të foluri, aluzive, jokorrekte krahasuar me normën, e nganjëherë ludike'...»⁵².

Duket qartë se te Ahmanova dhe *Larousse* kemi një rend të përmbytur të gjërave. Për studiuesen ruse zhargoni del në plan të parë dhe dallimi i vetëm mes tij dhe argosë ka të bëjë me ngjyrimin përkeqësues që mbart termi zhargon. Një ndarje e tillë e afron argonë më shumë me të ashtuquajturat *gjuhë speciale*. Ndërsa, sipas autorëve të *Larousse*-it, zhargoni në thelb është bir i argosë; më pas përdorimi i termit u shtri edhe mbi realitete të tjera, duke fituar një lloj mëvetësie në raport me të. Megjithatë, ata i veshin argosë attribute që ne jemi mësuar t'ia njohim zhargonit. Duke ruajtur termin zhargon, siç bën edhe Ahmanova, Bekaria jep një përkufizim që më shumë i qaset të sajit sesa atij të

⁵¹ Po aty, f. 272.

⁵² Gian Luigi Beccaria, (nën kujdesin e), *Dizionario di linguistica, e di filologia, metrica, retorica* Einaudi, 2004³, f. 356.

⁵³ Gaetano Berruto në veprën e cituar, f. 155, thotë se zhargonet janë në të njëjtën

Larousse-it. Siç mund të vërehet, përkufizimet e mësipërme pajtohen me njëri-tjetrin në disa pika.

Zhargoni është gjuha e një grupi shoqëror të caktuar, pra një sociolekt (vetëm Bekaria, me sa duket nën ndikimin e shkollës sociolinguistike italiane⁵³, lë të kuptohet se zhargoni mund të konceptohet edhe si stil të foluri, d.m.th. si një regjistër shtënia në punë e të cilit kushtëzohet nga situata e komunikimit); bartësit e tij duan të mos kuptohen nga pjesa tjetër e shoqërisë, prandaj i japin atij me dashje karakter kriptik (përsëri dallohet Bekaria, i cili në pjesën e fundit të përkufizimit lë të kuptohet se karakteri kriptik mund të mos jetë i qëllimshëm); për shkak të të cilit ai mbetet një variant parazitar në lidhje me gjuhën e përbashkët, i cili për hatër të moskuptimit, shmangies nga norma dhe marginalitetit të atyre që e flasin mbart edhe një ngjyrim përkeqësues. Por mes tyre ka edhe dallime njërin prej të cilëve e, pikërisht atë që lidhet me statusin e këtyre varianteve në kuptimin e ngushtë, e vura në dukje pak më lart. Një tjetër dallim ka të bëjë me karakterin ludik a zbatës të zhargonit, për të cilin bën fjalë vetëm Bekaria.

Pavarësisht prej ngjashmërive, unë besoj se nuk mund të vihet shenja e barazimit mes ligjërimit studentor dhe zhargonit të studentëve. Ligjërimi dëshiron t'i ruajë lidhjet me gjuhën e përbashkët, sepse bartësit e tij, më shumë se të veçohen nga shoqëria, synojnë të dallohen e të bien në sy. Që këtej del se edhe karakteri kriptik nuk është qëllim në vetvete, por efekt anësor i përftuar falë prirjes për t'u dalluar edhe gjuhësisht. Nga ana tjetër, zhargoni është më hermetik, më kompakt, pikërisht pse ai i përket një grupi më të vogël njerëzish, por edhe më i qëndrueshëm në kohë dhe kjo e fundit përbën pa dyshim karakteristikën që e dallon më shumë atë prej ligjërimit studentor. Por këto koncepte mund të dallohen edhe në një drejtim tjetër: në qoftë se zhargoni mba-

kohë variante diafazike dhe diastratike.

⁵⁴ Jörg Albrecht, *La lingua dei giovani* (nën kujdesin e Edgar Radtke-s), Tübingen-

het përgjithësisht si një variant diastratik, ligjërimi studentor është në të njëjtën kohë diastratik dhe diafazik; çka do të thotë me fjalë të tjera se bartësit e tij nuk përdorin vetëm atë dhe se e shtien punë në situata të caktuara e për të realizuar disa qëllime⁵⁴.

Përmasa ludike është një tjetër tipar mjaft i rëndësishëm i ligjërimit studentor. Fantazia dhe ‘originaliteti’ gjuhësor janë elemente që vlerësohen së tepërmi nga grupi. Një gjë e tillë është vënë re edhe në lidhje me shqipen, madje prof. Qemal Haxhihasani teksa përkufizon ‘variantin’ e nxënësve të Normales së Elbasanit thekson se këto të folme krijohen «për të shpëtuar nga vështirësitë e përgjigjes ndër mësimë, për të ba shaka me cenet e ndonjë pedagogu ose për ndonji aventurë gazmore të jetës studenteske»⁵⁵. Radtke thotë se: «Analizat sociologjike zbulojnë në sjelljen e të rinjve një prirje të fortë kah *narcizizmi* pasojat e së cilës [...] pasqyrohen edhe në përdorimet gjuhësore. Sipas sociologëve, tiparet e varianteve rinore shpjegohen me faktin se të rinjtë për të shenjuar identitetin e tyre, priren të dallohen edhe gjuhësisht prej grupeve të tjera [...]. Kjo e bën të mundur nocionin e ‘përmasës ludike’ si në sjelljen shoqërore, ashtu dhe në atë gjuhësore ...»⁵⁶. E njëjta prirje për narcizizëm në Itali njihet nën etiketën ‘triumfi i privates’. Novotnik është e mendimit se «...gjuha e të rinjve mund të quhet ‘sistem dytësor ludik’ i gjuhës standarde, të cilën ajo e parakupton, e shndërron në mënyrë krijuese dhe në të njëjtën kohë e stereotipizon»⁵⁷. Por, për mendimin tim, karakteri ludik i ligjërimit studentor lidhet ngushtë edhe me atë që unë e quajta pak më lart *funksioni zhvlerësues*. Është diçka e njohur tashmë që rrëzimi i ‘së vjetrës’ nis me vënien e saj në lojë.

Narr, 1993, f. 26.

⁵⁵ Qemal Haxhihasani, art. i cit., f. 123.

⁵⁶ Edgar Radtke, art. i cit., f. 9.

⁵⁷ Marlies Nowottnick, *Gioventù, lingua e mass media visti dalla prospettiva della*

Të rinjve u intereson vlerësimi subjektiv i realitetit. Për këtë arsye ata përpiqen ta thjeshtojnë, ta shkurtojnë e madje ta personalizojnë gjuhën e folur. E gjithë kjo bëhet për të afirmuar grupin dhe veten, për t'u dalluar nga 'bota e etërve' ose e 'pleqve', siç u pëlqen t'i quajnë, për të treguar se janë dikushi, pa qenë të detyruar t'u ngjasojnë. Por një qëndrim i tillë ndaj gjuhës së përbashkët buron edhe nga nevoja për një komunikim 'të përsheptuar' e 'të ngjeshur', të cilën gjuha e zakonshme është 'e pazonja' ta kënaqë.

Është e vërtetë se ligjërimi studentor nuk u përmbahet rregullave parashkruese të standardit, e në këtë kuptim ai është një *substandard*, por jo rrallë ai i largohet edhe dialektit. Ndonjë studiues shquan te substandardi dy shtresime që i kundërvihen njëri-tjetrit nga pikëpamja diakronike: *substandardin parësor* i cili përmban të gjitha elementet që u flakën tej prej puristëve në kohën kur u kodifikua norma gjuhësore e që mbijetuan deri më sot dhe *substandardin dytësor* ku përfshihen elementet e lindura pas kodifikimit e që nuk i binden normës e, prandaj, mund të përshkruhen si shmangie prej standardit⁵⁸.

Ndërsa Kostallari bën fjalë për *kundërnormën e vjetër dhe të re*⁵⁹, duke kuptuar me to pak a shumë të njëjtat shtresime që zura ngoje më lart. Në qoftë se ligjërimi studentor në shqipe daton aty nga vitet '80 të shekullit të shkuar, atëherë del se ai bën pjesë në *substandardin dytësor*. Njësitë i nënshtrohen një përpunimi që prek si veshjen tingullore, ashtu dhe kuptimet.

Le të sjellim ndër mend se ç'ka ndodhur me fjalën përshendetë-

linguistica tedesca, në *La lingua dei giovani* (nën kujdesin e Edgar Radtke-s), Tübingen-Narr, 1993, f. 166.

⁵⁸ Shih Jörg Albrecht, art. i cit., f. 27.

⁵⁹ Shih Androkli Kostallari, art. i cit.

⁶⁰ Shih Gjovalin Shkurtaç, *Onomastikë dhe etnolinguistikë*, SHBLU, Tiranë, 2001, f. 200.

se *tungjatjeta*. Ajo jo vetëm është shkurtuar përmes apokopës në *tung*, por është pasuruar edhe me kuptime të tjera⁶⁰, ndër të cilat më i pazakonti dhe më pak i pritshmi është ‘mirupafshim’, duke u kthyer kështu në një njësi polivalente, sepse po përdoret njësoj si për ta çelur komunikimin me dikë, ashtu dhe për ta mbyllur.

Përmes ngjeshjes së shprehësisë ligjërimi studentor ia ndrydh fjalës ‘së rëndomtë’ kuptimin fillestar, madje, falë përsëritjes në rrethana të ndryshme, ajo në krye mund ta humbasë ngjyrimin përkeqësues e pastaj të desemantizohet, duke e bjerrë vlerën e vet të origjinës. I tillë është, fjala vjen, rasti i njësive *trap*, *pallë*, *varja*, *kujt i plasi*, të cilat mund t’i dëgjosh edhe nga goja e vajzave.

Është thënë mëse një herë që kodi gjuhësor sendërton edhe një hapësirë sociale të vetën. Në këtë pikëpamje ligjërimi studentor dëshmon mes të tjerash edhe për një raport konfliktual me botën, për shkak të paqëndrueshmërisë së pozitës shoqërore dhe të pështjellimit emotiv, prandaj është e natyrshme që ai të shquhet për ‘tone të larta’. Është një “gjuhë” pasionante, ndonëse jo mirëfilli agresive. Ai është shumë më emotiv edhe se standardi.

Ky lloj emotiviteti i bie ndesh logjikës lineare së cilës i bindet varianti normativ. Duket se për studentët është e pamundur të flasin pa *fjalët-imazhe* dhe pa ‘nënkuptime’. Sidoqoftë, është e kuptueshme që të rinjtë e ndiejnë më shumë se të tjerët nevojën për t’u shprehur me patos, duke treguar se gjuha nuk është vetëm një mjet komunikimi, një ‘vegël’ që na ndihmon të shprehemi, por se ajo është edhe një realitet që na paraprin e në të cilin njeriu zhvillon edhe personalitetin e vet. Gjuha shndërrohet kështu në një mënyrë jetese e rritjeje, e aftë të përcjellë shije, botëkuptime e ndjenja. Kreativiteti i veçantë gjuhësor i studentëve ka një ndikim të madh mbi mënyrën se si ata e njohin dhe e përjetojnë gjithë përvojën njerëzore.

Prestigji që gëzon ky entitet krahasuar me sivëllezërit e vet, më shumë se nga cilësitë vjen prej statusit që kanë bartësit e tij në sytë e

anëtarëve të tjerë të bashkësisë. Kjo bën që studenti, edhe në mos qoftë një *folës model*, të jetë gjithsesi *folës me ndikim*. Natyrisht ky lloj ndikimi është më i madh ndër ata që mezi presin radhën për t'u bërë të tillë, domethënë te nxënësit e shkollave të mesme, të cilët jeta studentore ka me se t'i joshë. Megjithatë kjo nuk e shpëton ligjërimit studentor prej një lloj ngjyrimi përkeqësues i cili shpërfaqet në qëndrimin jo gjithmonë dashamirës të 'etërve' ndaj tij.

Është e lehtë të thuash se ligjërimi studentor mbetet peng i moskuptimit a i keqkuptimit e, për këtë arsye, e tërheq mbi vete edhe këtë lloj "armiçësie". Por më duket se kjo nuk mjafton. Si diçka që lind prej ndryshimit të raporteve mes bartësve të tij e botës për t'u bërë jehonë pikërisht këtyre ndryshimeve, në mos për t'i thelluar ato duke u rrekur t'u japë qytetarinë, ligjërimi studentor e ka në ADN-në e vet 'gjenin e pejorativitetit'.

Duke identifikuar grupin dhe individin, duke përmbushur *funkcionin* e vet *çlirues* e *zhvlerësues* ai do të zgjojë 'mërinë' e të gjithë atyre që s'mund të pajtohen me këtë 'shkarje nga binarët' dhe që gjuhën, me vetëdije ose jo, e kanë përdorur gjithnjë edhe si mjet të kontrollit shoqëror.

Nga ana tjetër, prindërit nuk mund të qëndrojnë indiferentë përballë faktit që teksta janë me njëri-tjetrin të rinjtë përgjithësisht flasin e flasin për orë të tëra, ndërsa para tyre e kyçin gojën. E kam fjalën për atë dukuri që njihet si *heshtja e të rinjve* ose si *afazia rinore* dhe që ka vënë në lëvizje një mori psikologësh e sociologësh. Pa i kuptuar gjer në fund shkaqet e kësaj heshtjeje, 'etërit' ngarkojnë me faj edhe 'gjuhën' e bijve.

Nuk gaboj po të them se ligjërimet rinore (e pra edhe ligjërimit studentor) janë në këtë mes 'dorëjashtë'. Edhe në rastin më të keq për këto 'variante', pra sikur të ishin vërtet të papërshtatshme për një ndërveprim verbal me të rriturit, bartësve të tyre mund t'u vinte në ndihmë *bilinguizmi rinor*.

Kjo do të thotë se rioshët heshtin, ngaqë duan të mos flasin dhe jo ngaqë s'munden. Autoritarizmit të dikurshëm 'të atit tiran', që fare mirë mund të shkërbehej duke përdorur gjuhën e gjesteve me gishtin tregues ngjitur te buzët, në këtë dhjetëvjetëshin e fundit ia ka zënë vendin një autoritarizëm i ri, ai i 'atit shok' që kërkon t'i thuhet të gjitha. Të rinjtë e kanë kuptuar këtë, prandaj heshtin.

Ajo që psikologët e quajnë *afazia rinore* në thelb përfaqëson një përpjekje të të rinjve për ta mbrojtur botën e vet prej rrezikut të jashtëm. Sipas një tjetër këndvështrimi, heshtja përballë prindërve është njëra nga shfaqjet e së ashtuquajturës *angushti e të rinjve*.

Them njëra nga shfaqjet, sepse ato më të zakonshmet, me të cilat duket se jemi mësuar tashmë, kanë të bëjnë me mungesën e dëshirës për të menduar mbi të ardhmen dhe me shndërrimin e së rrezikshmes në burim kënaqësie, gjë që pas të gjitha gjasave kompenson tek ata "paaftësinë" për të marrë mbi vete të tjera përgjegjësi.

Simptomatike është për sa i takon *angushtisë* edhe formula me të cilën bartësit e ligjërimit studentor e çelin sot komunikimin me njëri-tjetrin: *Ç'kemi? Ec varja ose shtyje*.

Në të vërtetë, nuk jemi shumë larg klishesë së 15 – 20 viteve të shkuara, e harruar tashmë: *Ç'kemi? Asgjë të re nga fronti i perëndimit*, e cila rimerrte në pjesën e dytë, natyrisht duke e ndryshuar pak për efekte komike, titullin e romanit të famshëm të Heminguejit *Në Perëndim, asgjë të re*.

Vërsnikët e mi mund të më kundërshtojnë duke thënë se *asgjë të re nga fronti i perëndimit* ne e kemi përdorur me një vlerë të posaçme, për të aluduar në lidhje me ndonjë vajzë. Kjo i përgjigjet pjesërisht së vërtetës, sepse aty nga fundi i viteve '80 njësia në fjalë u kthye në një *lemë flamur* që rrokte të tërën dhe jo vetëm dashurinë.

Prirja e kundërt, ajo për të folur me orë të tëra në shoqërinë e njëri-tjetrit, përveç *narcizizmit* ose *triumfit të privates* zbulon edhe nevojën që ndiejnë bartësit e këtij ligjërimit për të ndarë bashkarisht të

njëjtat përvoja, madje ka studiues që venë edhe më tutje duke folur për një ripërjetim kolektiv të së djeshmes, e cila i nënshtrohet gjykit të grupit. Ky i fundit bëhet kësisoj moderatori kryesor i sjelljes dhe jo vetëm i asaj gjuhësore.

Pa dashur të kontribuoj në konfuzionin terminologjik, që edhe pa ndihmesën time modeste është mjaft i madh, parapëlqej ta quaj ligjërimin studentor *entitet* dhe jo *variant*, sepse, sipas mendimit tim, atij i mungon ajo plotëri që i duhet *variantit* për të qenë i tillë.

Edhe pse nuk mund të identifikohet vetëm me fondin e vet leksikor, është një e vërtetë e pamohueshme se ligjërimi studentor dallohet prej elementeve të tjera të repertorit gjuhësor kryesisht në leksik dhe shumë më pak në morfologji e sintaksë. Prandaj termi *entitet* (jo aq neutral sa *varianti*) më duket më i goditur për realitete të këtij lloji, ngaqë nxjerr në spikamë një varësi më të madhe prej gjuhës amë, ligjërimit bisedor.

Burimet që e ushqejnë ligjërimin e sotëm studentor janë në thelb gjashtë: 1) shqipja bisedore; 2) dialektet; 3) ligjërimet e mëparshme studentore e rinore (*lemat konstante*); 4) risitë (*lemat flamur*); 5) gjuhët speciale (veçanërisht ato të informatikës e të televizionit) përmes të cilave ai komunikon më fort edhe me standardin dhe 6) huazimet nga gjuhët e tjera. Është e vërtetë se në ligjërimin e sotëm studentor mund të depërtojnë huazime edhe nëpërmjet secilit prej burimeve që përmenda, por unë e kam fjalën pikërisht për ato që ai merr për llogari të vet dhe drejtpërdrejt.